



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË NATYRËS

Nr. 461/3 Prot.



BASHKIA
TIRANË

Nr. 18584 Prot.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
MIDIS
FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË NATYRËS, UNIVERSITETI I TIRANËS
DHE
BASHKISË TIRANË

E lidhur sot më 25.10 2019 midis palëve:

Fakulteti i Shkencave të Natyrës, me adresë: “Bulevardi Zogu I, Tiranë”, përfaqësuar nga Dekani,
Prof. Dr. Spiro Drushku, në vijim e cilësuar si “**Fakulteti**”

dhe

Bashkia e Tiranës, me adresë: “Sheshi Skënderbej”, nr. 2, kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri,
përfaqësuar nga **Z. Erion Veliaj**, Kryetar, në vijim e cilësuar si “**Bashkia**”

Nisur nga:

Interesi dhe dëshira e mirë e të dy institucioneve për të bashkëpunuar me njeri-tjetrin, me qëllim ofrimin për studentët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës e zhvillimit të praktikës dhe trajnimit sipas nevojave të tregut të punës. Studentët nëpërmjet praktikave dhe trajnimeve profesionale do të krijojnë mundësi për të marrë një eksperience pune, si dhe do të zhvillojnë e zgjerojnë dijet e fituara në shkollë duke rritur mundësitë për punësim.

Palët lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti

Objekti i marrëveshjes është bashkëpunimi midis palëve në lidhje me zhvillimin e praktikave pranë Bashkisë Tiranë, për studentët e Fakultetit të Shkencave të Natyrës.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për "Vetëqeverisjen vendore".

Neni 3

Angazhimet e Palëve

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në frymën e një mirëkuptimi reciprok si dhe me vullnetin pozitiv për të siguruar kushtet e nevojshme për realizimin e angazhimit dhe iniciativat e ndërmarra nga njëra palë ose në bashkëpunim.

Fakulteti angazhohet të dërgojë listën me emrat e studentëve të cilët do të kryejnë praktikën pranë Bashkisë Tiranë.

Për periudhën e praktikës, studentët janë të detyruar t'i nënshtrohen rregullave dhe kërkesave të Bashkisë Tiranë.

Bashkia do të ofrojë kushtet e nevojshme për kryerjen e praktikës me qëllim përfitimin nga ana e studentëve të një kualifikimi sa më cilësor.

Çdo student në përfundim të praktikës do të marrë një çertifikatë/vërtetim nga Bashkia e Tiranës.

Neni 4

Njoftimet

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis palëve në këtë marrëveshje bëhen nepërmjet personave të kontaktit si më poshtë vijon:

- Për Bashkinë

Znj. Marsida Thartori

Specialiste, Drejtorja e Trajnimit dhe Zhvillimit

email: marsida.thartori@tirana.al

- Për Fakultetin

Prof. As. Alda Kika

Zv/Dekan për Kualifikimin Pedagogjiko-Shkencor

email: alda.kika@fshn.edu.al

Në rast ndryshimi të personit të kontaktit palët duhet të njoftojnë njëra-tjetrën, në mënyrë që komunikimi të vijojë normalisht.

Neni 5

Dispozitat e fundit

Palët përgjigjen reciprokisht për respektimin e kësaj marrëveshje.

- Kjo marrëveshje lidhet me afat 3 vjeçar;
- Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët;
- Kjo marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht me shkrim palën tjetër;
- Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje origjinale për secilën palë.

Fakulteti i Shkencave të Natyrës

Dekani



Prof. Dr. Spiro Drushku



Bashkia Tiranë

Kryetari



Z. Erion Veliaj

